



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 200/3 Prot.

Tiranë, më 30.01.2026

V E N D I M

Nr. 44, datë 30.01.2026

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të nenit 147/d, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

V E N D O S A:

1. Miratimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2026, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Njësia e Inspektorëve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



Lidhja nr. 1. Plani i inspektimeve për vitin 2026

Nr.	Lloji i inspektimit	Objekti i inspektimit	Periudha e realizimit të inspektimit	Organi i inspektuar	Afati i dorëzimit të raportit të inspektimit
1.	Tematik	Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Lezhë dhe Vlorë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025	16.02.2026 – 10.12.2026	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	10.12.2026
2.	Tematik	Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2025-31.12.2025	16.02.2026 – 21.12.2026	Të gjitha prokuroritë	21.12.2026
3.	Tematik	Inspektim vijues mbi ndjekjen e rekomandimeve të inspektimeve tematike miratuar me raportet nr. 608/4, datë 22.04.2024 dhe nr. 2495, datë 09.09.2025 “Mbi caktimin e çështjeve me short në prokurori”	16.02.2026 – 31.07.2026	Të gjitha prokuroritë	31.07.2026
4.	Tematik	Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën 01.04.2025-30.06.2025	16.02.2026 – 30.09.2026	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	30.09.2026

5.	Tematik	Mbi kohëzgjatjen e proceseve civile gjyqësore të përfunduara me palë kundërshtare, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për periudhën 01.04.2025- 30.06.2025	16.02.2026 - 30.10.2026	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	30.10.2026
6.	Tematik	Inspektim vijues mbi ndjekjen e rekomandimeve të inspektimit tematik miratuar me raportin nr. 56/29, datë 29.12.2023 për “Lirimi me kusht” në gjykata dhe prokurori	16.02.2026 - 30.10.2026	Të gjitha gjykatat dhe prokuroritë	30.10.2026
7.	Tematik	Respektimi i afateve të paraburgimit në kuadër të shuarjes së masave të sigurimit gjatë fazës së hetimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 2023-2025	16.02.2026 - 30.10.2026	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	30.10.2026
8.	Institucional	Infrastruktura dhe qarkullimi i dokumentacionit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 01.04.2025 - 30.06.2025	16.02.2026 -30.10.2026	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	30.10.2026
9.	Tematik	Trajtimi i referimeve dhe kallëzimeve penale ndaj punonjësit të policisë së shtetit dhe policisë së burgjeve për torture, keqtrajtim, veprime arbitrare apo dhunë të çdo lloji forme, për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025	16.02.2026 – 02.12.2026	Të gjitha prokuroritë	02.12.2026